



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister

Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistiku Kosova - Statistical Agency of Kosovo

Bazuar në nenin 8 pika 3.1, nenit 6 pika 5 dhe nenit 33 të Ligjit Nr.04/L-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës, Udhëzimit Administrativ Nr.08/2012 për kushtet dhe Mënyrën e Ofrimit të të Dhënave të Fituara me Përpunime të Veçanta të Statistikave Zyrtare si dhe nenit 12 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/ L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjin Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, **Agjencia e Statistikave të Kosovës bënë:**

Shpalljen e Konkursit Publik për Marrëveshje për Shërbime të Veçanta

Emri i Institucionit	Agjencia e Statistikave të Kosovës
Titulli i pozitës(ave):	Anketues për MICS Pre-Test
Tarifa e shërbimit:	
Raporton te:	Kordinatorit për MICS anketën
Lloji i kontratës:	Marrëveshje për Shërbime të Veçanta - (MSHV)
Kohëzgjatja e kontratës:	Një (1) muaj
Orari i punës:	I plotë
Lokacioni dhe numri i anketuesve:	16 anketues (10 femra dhe 6 meshkuj)

Në kuadër të bashkëpunimit në mes të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) dhe Fondacionit të Kombeve të Bashkuara për Fëmijë (UNICEF) për implementimin e Anketës së Treguesve të Shumëfishtë 2019 (MICS) në Kosovë, ASK ofron mundësinë e angazhimit për kandidatë të interesuar për punë në terren në regionin e Prishtinës , sipas detyrave të përshkruara më poshtë.

Detyrat dhe përgjegjësitë e intervistuesve për MICS anketën:

- Të marrë pjesë në trajnime dhe të njihet me Udhëzimet Metodologjike dhe Organizative lidhur me pyetësorë e ekonomisë familjare, pyetësorë individual për gra dhe burra, pyetësorë për fëmijët nën moshën pesë vjeçare dhe pyetësorë për fëmijë të moshës 5-17 vjeçare;
- Të zhvillojnë grumbullimin e të dhënave për anketën e MICS me metodologjinë CAPI (Tablet);
- Të respektojnë udhëzimet e pyetësorit dhe të ndjekin të gjitha procedurat dhe sqarimet e përshkruara në udhëzime;
- Të punojë në ekip dhe në koordinimi me udhëzimet e mbikqyrësit;
- Të njoftojë mbikqyrësin për problemet dhe pasiguritë e mundshme gjatë punës në terren dhe të konsultohet për vazhdimin e punës;

Përgatitja shkollore dhe përvoja:

- Të jenë studentë apo të diplomuar ;
- Komunikim i shkëlqyeshëm dhe shkathtësi ndërpersonale;
- Disponueshmëria dhe gatishmëria për të udhëtuar në të gjitha rajonet e Kosovës;
- Gatishmëria për të punuar në ekip;
- Përvojë në marrjen e matjeve antropometrike, kryerjen e intervistave ballë për ballë ose eksperiencë të anketimit në terren;

Kompetenca dhe aftësitë:

- Aftësi shumë të mirë gjuhësore (për të lexuar, shkruar dhe folur) në gjuhën shqipe ose serbe
- Aftësi të mira për të komunikuar dhe bashkëpunuar;
- Aftësi të mira për orientim në hapësirë (përdorimin e hartave për identifikimin e objekteve të banimit);
- Aftësi të mira organizative dhe sipas nevojës, të jetë i gatshëm të punojë me orarë pune fleksibil;
- Aftësi kompjuterike, Word, Excel, Internet etj;

Shënim: Kandidatët nga komunitetet Rom, Ashkalinje dhe Egjiptian me përgatitje shkollore më të ulët se diploma univerisitare, do të konsiderohen për vazhdim në proces.

Kushtet për aplikim:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë Qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore (mbi 18 vjet) të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësitë fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

Konkursi është i hapur 5 ditë kalendarike nga dita e publikimit në mjetet e informimit dhe në Ueb-faqen e ASK-së dhe UNICEF.

Si të aplikohet:

Online: Duke plotësuar të dhënat e kërkuara në linkun e mëposhtem:

<https://forms.gle/9VcsmvGCJReGWdWs5>

Offline: CV, kopja e letërnjoftimit, dëshmia e të ndjekes së studimeve (vërtetimi nga fakulteti) ose diploma univeristare dhe formulari i shkakruar nga webfaqja e ASK <http://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/fund-faqe/mundes-punesimi>, të dorëzohen në ASK .

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen dhe duhet t'i nënshtrohen testimit me shkrim dhe intervistës.

Për më shumë informata lidhur me MICS vizitoni <http://mics.unicef.org>